

VENDIM

Nr.1374, datë 10.10.2008

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE TË PROCEDURAVE, QË NDIQEN PËR HEQJEN, SHTIMIN DHE NDRYSHIMIN E DESTINACIONIT TË FONDIT KULLOSOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 10 të ligjit nr.9693, date 19.3.2007 "Për fondin kullosor", me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në kuptim të këtij vendimi, me termat e mëposhtëm do të nënkuptohen:

- a) "Heqje", veprimin e çregjistrimit të një sipërfaqeje kullote ose livadhi nga Regjistri i Fondit Kullosor, pas miratimit nga organet përgjegjëse;
- b) "Shtim", veprimin e regjistrimit të një sipërfaqeje kullote ose livadhi në Regjistrin e Fondit Kullosor, me prejardhje nga kategori të tjera tokash, pas miratimit nga organet përgjegjëse;
- c) "Ndryshim destinacioni", veprimin që pasqyron ndryshimin në Regjistrin e Fondit Kullosor, për kalimin nga një kategori përdorimi në tjetrën.

2. Personat, fizikë ose juridikë apo organet e qeverisjes vendore, për kullotat e livadhet komunale, paraqesin në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimi të Ujërave kërkesën për heqjen e sipërfaqes nga fondi kullosor.

3. Kërkesa për heqjen e sipërfaqeve nga fondi kullosor është e vlefshme vetëm kur bëhet për veprimtaritë e përcaktuara në nenin 17 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, dhe që janë në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr.9693, date 19.3.2007 "Për fondin kullosor".

4. Personat, fizikë ose juridikë apo organet e qeverisjes vendore, për kullotat e livadhet komunale, e paraqesin kërkesën te ministri vetëm pasi kanë siguruar lejen, licencën ose dokumentin, të lëshuar nga organi i ngarkuar me ligj për miratimin e veprimtarisë.

5. Kërkesa bëhet me shkrim dhe përmban gjeneralitetet e kërkuarit dhe të subjektit që ai përfaqëson, një përshkrim të shkurtër të veprimtarisë që do të ushtrojë, investimet që do të bëjë dhe kohëzgjatjen e zbatimit të projektit.

6. Kërkesa shoqërohet me dokumentet e mëposhtme:

- a) Njoftimin e ministrisë nga organi shtetëror që ka miratuar veprimtarinë, ku sqarohet se për nevoja të ushtrimit të veprimtarisë së miratuar prej tij, sipërfaqja e kërkuar të hiqet nga fondi kullosor;
- b) Kopje të noterizuar të lejes apo të dokumentit, me të cilin i është miratuar veprimtaria, nga institucioni i ngarkuar me ligj;
- c) Planimetrinë e sipërfaqes së kërkuar në hartën topografike të dixhitalizuar dhe të gjeoreferuar, në shkallën 1:10 000, ku të jenë evidentuar elementet kryesore, si kufijtë natyrorë, relievi, objektet, si dhe çdo planimetri tjetër, në shkallë më të hollësishme, hartuar në përputhje me kërkesat e studimit apo të projektit.

7. Ministria, pas depozitimit të kërkesës, i kërkon drejtorisë përkatëse të shërbimit pyjor identifikimin e

ngastrave dhe të nënngastrave të kërkuara dhe hartimin e raportit teknik për to, brenda 1 jave. Ky raport i përcillet ministrisë brenda 10 ditëve nga data që ajo e ka kërkuar. Kur heqja kërkohet nga fondi kullor komunal, drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor harton raportin teknik, në bashkëpunim me njësinë tekniko-administrative të pyjeve e kullotave të njësisë së qeverisjes vendore.

8. Ministria mund t'ia kthejë personit, fizik ose juridik, dokumentacionin e paraqitur për plotësime e saktësime. Koha për plotësimin e dokumentacionit nuk llogaritet në afatin e përcaktuar për shqyrtimin e kërkesës, i cili është një muaj.

9. Në bazë të dokumentacionit të mësipërm:

a) ministri nxjerr urdhrin për heqjen nga fondi kullor, për sipërfaqe deri në 1 ha;

b) ministria përgatit projektvendimin për heqjen nga fondi kullor, për sipërfaqe mbi 1 ha, dhe e dërgon atë, për shqyrtim e miratim, në Këshillin e Ministrave.

10. Pas miratimit të heqjes së sipërfaqes nga fondi kullor:

a) drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor bën përditësimin në regjistrimin e kullotave, që ajo administron, dhe të dhënat i përcjell në ministri;

b) ministria bën përditësimin në Regjistrin Kombëtar të Kullotave;

c) zyra përkatëse e regjistrimit të pasurive të paluajtshme bën transferimin e regjistrimit nga kategoria "Tokë e zënë me kullotë apo livadh" në kategorinë përkatëse të përdorimit.

11. Sipërfaqja, që hiqet nga fondi kullor publik, në përputhje me këtë vendim, ndryshon destinacionin e përdorimit, por, në çdo rast, mbetet në pronësi publike.

12. Vlera e sipërfaqes kullorë të hequr dhe e infrastrukturës së saj paguhet nga kërkuesi para hyrjes në fuqi të aktit të miratimit, të përmendur në shkronjat "a" e "b" të pikës 8 të këtij vendimi dhe derdhet në llogarinë bankare të ministrisë, ndërsa për kullotat komunale derdhet në llogarinë bankare të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse.

13. Kërkuesi, për shërbimin e kryer nga ministria, paguan një tarifë shërbimi, në vlerën 20 000 lekë, në llogarinë bankare të ministrisë, në kohën e paraqitjes së kërkesës. Kjo vlerë nuk kthehet edhe nëse kërkesa nuk miratohet.

14. Shtimi i sipërfaqes së fondit kullor bëhet në rastet e ndryshimit të kategorive të përdorimit të tokës nga tokë pyjore, tokë e pafrytshme ose formime nga deltat e reja të lumenjve, në kullotë apo livadh.

15. Nëse kërkesën për t'i ndryshuar destinacionin një pjese apo të gjithë kullotës a livadhit, që ka në pronësi, e bën pronari privat, në kërkesë përcaktohen:

a) edhe sipërfaqja, që do t'i ndryshohet destinacioni;

b) edhe veprimtaria për çfarë do të përdoret (veprimtaria, që do ushtrohet, apo objekti, që do të ndërtohet në të).

16. Kërkesa shoqërohet me këto dokumente:

a) Kopjen e noterizuar të dokumentit të pronësisë së kullotës apo livadhit;

b) Studimin apo projektin e veprimtarisë që do të ushtrohet, apo të veprës që do të ndërtohet;

c) Kopjen e noterizuar të licencës, që ka miratuar veprimtarinë apo ndërtimin e objektit;

ç) Planimetrinë e sipërfaqes, që kërkohet t'i ndërrohet destinacioni, në hartë topografike, në shkallën 1:10 000, ku të jenë evidentuar kufijtë natyrorë, relievi, objektet dhe kufijtë e kullotës, që mbetet pas miratimit të kërkesës;

d) Mandatpagesën e tarifës së shërbimit, sipas pikës 14 të këtij vendimi.

17. Kërkesa shqyrtohet nga drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes. Me kalimin e këtij afati, kërkesa quhet e miratuar. Drejtoria e shërbimit pyjor dhe ministria bëjnë përditësimet në regjistrat e kullotave.

18. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha